

Këshilli për dhënien e Çmimit Shtetëror “ 22 Nëntori” shpall:

## **KONKURS**

për ndarjen e Çmimit Shtetëror “ 22 Nëntori” për vitin 2022

Me Çmimi Shtetëror “22 Nëntori” u jepet mirënjohje njerëzve të jetës politike, kulturore dhe shoqërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në avancimin e bashkëjetesës ndërnjerëzore dhe mirëkuptimit të ndërsjellë midis pjesëtarëve të komuniteteve, kulturave dhe feve të ndryshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Çmimi shtetëror u ndahet individëve, grupeve të krijuesve, ekipeve, institucioneve, shoqërive tregtare dhe shoqatave të qytetarëve.

Sipas kushteve të caktuara në konkurs Çmimi shtetëror mund t’u ndahet edhe shtetasve të huaj, grupeve të krijuesve, ekipeve dhe institucioneve të huaja.

Individi që do ta fitojë këtë Çmim i ndahet diplomë dhe shuma në para.

Çdo anëtar i të grupit të krijuesve ose ekipit që do ta fitojë këtë Çmim do tu jepen diploma dhe pjesë e barabartë e shumës në para.

Institucioni, shoqëria tregtare ose shoqata e qytetarëve që do ta fitojë këtë Çmim u ndahet diploma dhe plaketa.

Shuma në para e Çmimit Shtetëror “22 Nëntori” është pesë (5) rroga mujore mesatare në Republikën e Maqedonisë së Veriut të paguara në tre muajt e fundit të vitit vijues.

Çmimi Shtetëror “22 Nëntori” ndahet, sipas rregullit, në çdo vjet.

Më së shumti mund të ndahen deri në dy çmime në vit.

Iniciativë për ndarjen e Çmimit Shtetëror “22 Nëntori” mund të parashtrojnë: institucionet, shoqëritë tregtare, shoqatat e qytetarëve dhe qytetarët.

Parashtuesit e iniciativës për ndarjen e Çmimit Shtetëror duhet hollësisht ta arsyetojnë iniciativën. Teksti duhet të përmbajë të dhënat e sakta të biografisë, adresën e saktë të vendbanimit (adresa-rruga, numri, vendi, qyteti, shteti), të dhënat për rezultatet e arritura në fushën në të cilën është dëshmuar ai dhe të dhënat e tjera që konsiderohen se do të kontribuojnë në vlerësim.

Parashtuesi i iniciativës duhet ta theksojë emrin dhe mbiemrin e plotë, titullin, firmën, adresën dhe telefonin.

Teksti i iniciativës (i kompletuar) të dorëzohet në 20 ekzemplarë, ndërsa punimet, (librat, publikimet, etj.) trajtohen si shtojcë dhe duhet të dorëzohen në një (1) ekzemplar.

Adresa në të cilën duhet të dërgohen iniciativat, është:

Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Këshilli për Ndarjen e Çmimit Shtetëror “22 Nëntori”, rr. ”Gjuro Gjakoviq” nr. 61 – Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut.

### **Konkursi zgjat nga 1 deri më 31 maj 2022**

Iniciativat dhe propozimet (punimet, librat, publikimet, etj.) të dërguara pas afatit të caktuar për t’i pranuar, si dhe iniciativat e pakompletuara nuk do të shqyrtohen nga ana e këshillit.

Këshilli për Ndarjen e Çmimit Shtetëror  
“22 Nëntori”